

Nr.Prot. 1163

**VENDIM**  
**I**  
**ASAMBLESE SE ORTAKEVE TË SHOQERISE "GENER 2" SH.P.K.**

Ne mbështetje të Ligjit Nr. 9901, date 14.04.2008 "Per Tregtaret dhe Shoqerite Tregtare", I ndryshuar, Neni 68, Neni 81, pika 1, germa "ë", te Ligjit Nr. 9723, date 03.05.2007 "Per Qendren Kombetare te Regjistrimit", Neni 43, te Neni 9 te Statutit te shoqerise "GENER 2" Sh.p.k.;

Sot me date 03/08/2021, mbahet kjo Mbledhje e Asamblese se Ortakeve te Shoqerise me pergjegjesi te kufizuar "GENER 2" Sh.p.k. ("Shoqeria"), person juridik shqiptar, i regjistruar ne Regjistrin e Shoqerive Tregtare me Vendimin e Gjykates se Shkalles se Pare Tirane Nr. 30145 date 03.09.2003, me Nipt Nr. K58615301M, me seli ne adresen: Rruga "Papa Gjon Pali i II-te", ABA Business Center, Tirane", me objekt veprimtarie ushtrimin e aktivitetit privat ne fushen e ndertimit etj.

**Te pranishem ne mbledhje:**

1. Z. Ahmet Ulaj, shtetas shqiptar, i biri i Isës dhe Zades, i datëlindjes 01.08.1951, i lindur ne Vuthaj, banues në Tiranë, ne adresën: Rruga "Mustafa Matohiti"; Zoterues dhe pronar i 1 pjese qe perben 33 % (tridhjetë e tre perqind) te Kapitalit te shoqerise, perfaqesuar nga Z. Bashkim Ulaj nepermjet Prokures se Pergjitheshme Nr. 2145Rep/349kol, date 13.04.2015, noterizuar nga Notere Xh. Brahaj;
2. Z. Astrit Ulaj, shtetas shqiptar, i biri i Ises dhe Zades, i datelindjes 1967, banues ne Rrugen "Ismail Qemali"; Zoterues dhe pronar i 1 pjese qe perben 33 % (tridhjetë e tre perqind) te Kapitalit te shoqerise, perfaqesuar me Prokuren e Pergjithshme Nr. 2146Rep/350kol, date 13.04.2015, noterizuar nga Notere Xh. Brahaj, nga Z. Bashkim Ulaj;
3. Z. Bashkim Ulaj, shtetas shqiptar, i biri i Ises dhe Zades, lindur me 15.03.1963 ,banues ne Tirane ne adresën Rr."Mustafa Matohiti"; Zoterues dhe pronar i 1 pjese qe perben 34 % (tridhjetë e kater perqind) te Kapitalit te shoqerise;

**Rendi i Dites: Zmadhimi I kapitalit te rregjistruar te Shoqerise, nepermjet Kontributit ne natyre (pasuri e paluajteshme) nga Ortaket Astrit Ulaj dhe Bashkim Ulaj;**

Pas diskutimeve ne lidhje me ceshtjen e mesiperme, Asambleja e Pergjithshme e Ortakeve ne menyre unanime:

**Vendos:**

1. Pranimin e Kontributit ne natyre (pasurie paluajteshme) qe vendoset nga Ortaket Astrit Ulaj dhe Bashkim Ulaj, me te dhenat e meposhtme:
  - 1) Pasuria e paluajteshme, regjistruar ne Agjencine Shteterore te Kadastres (ish-ZVRPP), Zona kadastrale nr. 8270, Numri i Pasurise 3/110+1-G15, me Kod Unik





8270058180, Adresa e Pasurise: Rruga "Nikolla Tupe", Tirane, Lloji i pasurise: Garazh, me Siperfaqe: 15 m<sup>2</sup> (pesembedhete metra katrore), ne pronesi te Bashkim Ulaj

- 2) Pasuria e paluajteshme, regjistruar ne Agjencine Shteterore te Kadastres (ish-ZVRPP), Zona kadastrale nr. 8270, Numri i Pasurise 3/110+1-G16, me Kod Unik 8270058181, Adresa e Pasurise: Rruga "Nikolla Tupe", Tirane, Lloji i pasurise: Garazh, me Siperfaqe: 15 m<sup>2</sup> (pesembedhete metra katrore) ne pronesi te Bashkim Ulaj;
  - 3) Pasuria e paluajteshme, regjistruar ne Agjencine Shteterore te Kadastres (ish-ZVRPP), Zona kadastrale nr. 8270, Numri i Pasurise ND-2/2/261-B18, me Kod Unik 8160028065, Adresa e Pasurise: Rruga "M. Matohiti", Tirane, Lloji i pasurise: Bodrum, me Siperfaqe: 20 m<sup>2</sup> (njezete metra katrore) ne pronesi te Bashkim Ulaj;
2. Fillimin e Proçedurës për rritjen e kapitalit të rregjistruar të Shoqërisë "GENER 2" Shpk, si rezultat i vendosjes së kontributit në natyrë nga Ortaket Astrit Ulaj dhe Bashkim Ulaj, kontribut i përbërë prej pasurive të paluajteshme në pronësi të tyre, të përshkruara në pikën 1 të këtij Vendimi.
  3. Shtesa e kapitalit të rregjistruar që do të rezultojë nga Vlerësimi I Kontributit në natyrë të Ortakeve Bashkim Ulaj dhe të Astrit Ulaj, të përshkruar në pikën 1 të këtij Vendimi, do të shpërndahet tek të gjithë Ortaket e Shoqërisë në përputhje me përqindjen e pjesëmarrjes që zoterojnë në kapitalin e rregjistruar të Shoqërisë:
    - 1) Z. Ahmet Ulaj, Zotëruar dhe pronar të 33 % (tridhjetë e tre përqind) të Kapitalit të shoqërisë.
    - 2) Z. Astrit Ulaj, Zotëruar dhe pronar të 33 % (tridhjetë e tre përqind) të Kapitalit të shoqërisë.
    - 3) Z. Bashkim Ulaj, Zotëruar dhe pronar të 34 % (tridhjetë e katër përqind) të Kapitalit të shoqërisë.
  4. Caktimin e "FILTO Auditing" Shpk, një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar, themeluar në bazë të legjislacionit shqiptar datë 01.02.2008, NUIS Nr. K81401002H, me përfaqësues ligjor Zj. Tatjana Filto (Kotepano), me Licence Nr.67, datë 10.02.2000, të leshuar nga Instituti i Ekspertëve Kontabel të Autorizuar të Shqipërisë (IEKA), si Auditues Ligjorë e Autorizuar nga Ortaket e Shoqërisë për kryerjen e Aktit të Ekspertimit, i cili do të evidentojë vlerësimin e kontributit në natyrë dhe vlerën e rritjes së kapitalit të rregjistruar të Shoqërisë "GENER 2" Sh.p.k.;
  5. Depozitimin e këtij vendimi, pranë Qendrës Kombëtare të Regjistrimit;


Pas përfundimit të temave të rendit të ditës, shpallet mbyllja e mbledhjes.

Ky akt lexohet nga Ortaket, të cilët deklarojnë se pranojnë përmbajtjen e tij duke shprehur vullnetin e tyre të lire dhe të plote. Ortaket nënshkruajnë këtë akt në përputhje me Ligjin.



ASAMBLEJA E ORTAKEVE TE SHOQERISE "GENER 2" SH.P.K

Z. AHMET ULAJ & Z. ASTRIT ULAJ  
Perfaqesuar me Prokure nga  
Z. BASHKIM ULAJ



Z. BASHKIM ULAJ



Vendosja e Pasurive te Paluajteshme te pershkruara ne piken 1.1 dhe 1.2 te ketij Vendimi si Kontribut ne natyre e Ortakut Bashkim Ulaj ne Shoqeri, dhe disponimi i tyre sipas ketij Vendimi, miratohet nga Zj. Donieta Ulaj, bashkeshortja e Z. Bashkim Ulaj, e cila jep pelqimin e saj konform dispozitave te Ligjit Nr. 9062, date 08.05.2003 "Kodi i Familjes"; shtetase shqiptare, e datelindjes 18 Prill 1973, banuese ne Tirane, Rruga "Mustafa Matohiti" Pall. 7, madhore dhe me zotesi te plote juridike per te vepruar, e pajisur me leternjoftimin me nr. personal H35418203A, perfaqesuar me Prokuren e posacme Nr. 2366 Rep dhe 596 Kol., date 12.07.2007 te Noteres Xhevahire Brahaj nga Bashkeshorti Z. Bashkim Ulaj;

Z. BASHKIM ULAJ



Vendosja e Pasurise se Paluajteshme te pershkruar ne piken 1.3 te ketij Vendimi si Kontribut ne natyre e Ortakut Astrit Ulaj ne Shoqeri, dhe disponimi i tij sipas ketij Vendimi, miratohet nga Zj. Sehrija Ulaj, bashkeshortja e Z. Astrit Ulaj, e cila jep pelqimin e saj konform dispozitave te Ligjit Nr. 9062, date 08.05.2003 "Kodi i Familjes"; shtetase amerikane, e datelindjes 01.05.1973, madhore dhe me zotesi te plote juridike per te vepruar, mbajtese e pasaportes amerikane nr 507231148, Perfaqesuar me Prokuren e Pergjithshme Nr. 4598Rep dhe Nr. 951Kol, date 02.08.2021, nga Z. Bashkim Ulaj;

Z. BASHKIM ULAJ





**VENDIM**  
**I**  
**ASAMBLESE SE ORTAKEVE TË SHOQERISE "GENER 2" SH.P.K.**

Ne mbështetje të Ligjit Nr. 9901, date 14.04.2008 "Per Tregtaret dhe Shoqerite Tregtare", I ndryshuar, Neni 68, Neni 81, pika 1, germa "ë", te Ligjit Nr. 9723, date 03.05.2007 "Per Qendren Kombetare te Regjistrimit", Neni 43, te Nenit 9 te Statutit te shoqerise "GENER 2" Sh.p.k.;

Sot me date 17.08.2021, mbahet kjo Mbledhje e Asamblese se Ortakeve te Shoqerise me pergjegjesi te kufizuar "GENER 2" Sh.p.k. ("Shoqeria"), person juridik shqiptar, i regjistruar ne Regjistrin e Shoqerive Tregtare me Vendimin e Gjykates se Shkalles se Pare Tirane Nr. 30145 date 03.09.2003, me Nipt Nr. K 58615301 M, me seli ne "Lezhe, Mamurras", me objekt veprimtarie ushtrimin e aktivitetit privat ne fushen e ndertimit etj.

Kapitali i regjistruar i Shoqerise eshte ne masen 10,755,383,219.00 (dhjete miliard e shtateqind e pesedhjete e pese milion e treqinde e tetedhjete e tre mije e dyqind e nentembdhjete) Leke. Numri i pjeseve eshte 3.

**Te pranishem ne mbledhje:**

1. Z. Ahmet Ulaj, shtetas shqiptar, i biri i Isës dhe Zades, i datëlindjes 01.08.1951, i lindur ne Vuthaj, banues në Tiranë, ne adresën: Rruga "Mustafa Matohiti"; Zoterues dhe pronar i 1 pjese qe perben 33 % (tridhjete e tre perqind) te Kapitalit te shoqerise ne vlere 830,985,096.00 Leke dhe ne natyre ne vleren 2,718,291,366.00 Leke, perfaqesuar nga Z. Bashkim Ulaj nepermjet Prokures se Pergjitheshme Nr. 2145Rep/349kol, date 13.04.2015, noterizuar nga Notere Xh. Brahaj.

2. Z. Astrit Ulaj, shtetas shqiptar, I biri I Ises dhe Zades, i datelindjes 1967, banues ne Rrugen "Ismail Qemali"; Zoterues dhe pronar i 1 pjese qe perben 33 % (tridhjete e tre perqind) te Kapitalit te shoqerise ne vlere 830,985,096.00 Leke dhe ne natyre ne vleren 2,718,291,366.00 Leke, perfaqesuar nga Z. Bashkim Ulaj nepermjet Prokures se Pergjitheshme Nr. 2146Rep/350kol, date 13.04.2015, noterizuar nga Notere Xh. Brahaj.

3. Z. Bashkim Ulaj, shtetas shqiptar, i biri i Ises dhe Zades, lindur me 15.03.1963 ,banues ne Tirane ne adresën Rr."Mustafa Matohiti"; Zoterues dhe pronar i 1 pjese qe perben 34 % (tridhjete e kater perqind) te Kapitalit te shoqerise ne vlere 856,166,463.00 Leke dhe ne natyre ne vleren 2,800,663,832.00 Leke.

**Rendi i Dites:** Shqyrtimi i Raportit te Audituesit Ligjor te autorizuar, "FILTO Auditing" Shpk, per zmadhimin e kapitalit te Rregjistruar te Shoqerise nepermjet fitimit te vitit 2020 si dhe nepermjet kontributit ne natyre (pasuri e paluajteshme).

Pas diskutimeve ne lidhje me ceshtjen e mesiperme, Asambleja e Pergjithshme e Ortakeve ne menyre unanime:

**Vendos:**





1. Miratimin e Raportit të Ekspertit Kontabel të autorizuar "FILTO Auditing" Shpk, për shtimin e kapitalit të shoqërisë në vlerën 279,516,000 (dyqind e shtatëdhjetë e nëntë milion e pesëqindë e gjashtëmbëdhjetë mijë) Leke, i përbërë nga vlera e fitimit të vitit 2020 në masën prej 272,908,000 leke si dhe vlera e kontributit në natyrë të ortakëve Bashkim Ulaj dhe Astrit Ulaj i përbërë prej pasurive të paluajtshme në shumën 6,608,000 leke.
2. Miratimin e rritjes së kapitalit të shoqërisë "GENER 2" sh.p.k. në vlerën prej 279,516,000 (dyqind e shtatëdhjetë e nëntë milion e pesëqindë e gjashtëmbëdhjetë mijë) Leke.
3. Kapitali themeltar i shoqërisë "GENER 2" Sh.p.k. bëhet në masën 11,034,899,219 (njëmbëdhjetë miliard e tridhjetë e katër milion leke e teteqindë e nëntëdhjetë e nëntë mijë e dyqind e nëntëmbëdhjetë) Leke, dhe do të zotërohet nga Ortaket e Shoqërisë, me përqindjet e pjesëmarrjes së pronësive, si më poshtë:

Ortaket	% në kapital	Kapitali	Shtesa kapitalit	Kapitali Behet
Ahmet Ulaj	33	3,549,276,462	92,240,280	3,641,516,742
Bashkim Ulaj	34	3,656,830,294	95,035,440	3,751,865,734
Astrit Ulaj	33	3,549,276,462	92,240,280	3,641,516,742
		10,755,383,219	279,516,000	11,034,899,219

Kapitali i shoqërisë bëhet 11,034,899,219 leke nga i cili në natyrë është 8,243,854,564 leke ndahet si më poshtë:

Ortaket	% në kapital	Kapitali	Ne Natyrë	Ne Para
Ahmet Ulaj	33	3,641,516,742	2,720,472,006	921,044,736
Bashkim Ulaj	34	3,751,865,734	2,802,910,552	948,955,183
Astrit Ulaj	33	3,641,516,742	2,720,472,006	921,044,736
		11,028,980,719	8,237,936,064	2,791,044,655

4. Depozitimin e Vendimit të Asamblesë së Ortakëve datë 03.08.2021 dhe Vendimit datë 17.08.2021 dhe të Raportit për Zmadhimin e Kapitalit të Audituesit Ligjor "FILTO Auditing" Shpk, i cili është pjesë integrale dhe e pandarë e këtij Vendimi pranë Qendres Kombëtare të Regjistrimit;
5. Depozitimin e Vendimit të Asamblesë së Ortakëve pranë Agjencisë Shtetërore të Kadastrës Tiranë, për kryerjen e regjistrimit të Kontributit në natyrë (pasurive të paluajtshme) në pronësi të shoqërisë "GENER 2" Sh.p.k.

Pas perfundimit te temave te rendit te dites, shpallet mbyllja e mbledhjes.

Ky akt lexohet nga Ortaket, te cilet deklarojne se pranojne permbajtjen e tij duke shprehur vullnetin e tyre te lire dhe te plote. Ortaket nenshkruajne kete akt ne perputhje me Ligjin.

**ASAMBLEJA E ORTAKEVE TE SHOQERISE "GENER 2" SH.P.K**

**Z. AHMET ULAJ & Z. ASTRIT ULAJ**  
Perfaqesuar me Prokure nga  
**Z. BASHKIM ULAJ**



**Z. BASHKIM ULAJ**

